



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1980 / Prot.

Tiranë, më 14.12.2020

VENDIM

Nr. 47, datë 23.12.2020

“Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional" në "Gazetari Investigative" në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të UT”

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, germa b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, germa “dh”; neni 75: Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, germa “A”; Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa “f” si dhe në propozimin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë me shkresën Nr. 676 Prot., datë 16.10.2020, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 23.12.2020;

VENDOSI:

1. Të hapë programin e ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional " në "Gazetari Investigative", në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të UT-së, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional " në "Gazetari Investigative", të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të UT-së.
3. Dokumentacioni përkatës t’i përcillet për miratim Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Dokumentacioni përkatës të përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha